



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:118382

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05759000

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në lëndën penale kundër të pandehurit A.K me numër të letërnjoftimit ..., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1570/2023, të datës 22.04.2024, si dhe bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim më datë 30.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- 1. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurë të ndërmjetësimit** në lëndën **P.nr.91/2024** dhe me numër të marrëveshjes **ND: 116/2024**, e arritur me datën 30.05.2024 e pranuar nga gjyqtari me datë 30.05.2024, për të pandehurin e cekur si në pjesën hyrëse të këtij aktvendimi.
- Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përmbarues sipas dispozitave ligjore në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.
- Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse dhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.
- Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë gjyqësore.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2024:118382, 30.05.2024**

**Gj y q t a r i
Agron Maxhuni**